

BANKA E SHQIPËRISË

B U L E T I N I
Z Y R T A R

vëllimi 26 numër 9 dhjetor 2024

Data e botimit: 31.12.2024

P Ë R M B A J T J A

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 62, datë 4.12.2024
"Për rishtypjen e monedhave metalike shqiptare me kurs ligjor, me prerje 5 Lekë dhe 10 Lekë" 5
 2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 64, datë 4.12.2024
"Për caktimin e kontrollorit të jashtëm të pasqyrave financiare të Bankës së Shqipërisë dhe të fondit të pensionit suplementar për vitet 2024-2028" 6
 3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 65, datë 18.12.2024
"Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë" 8
 4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 68, datë 18.12.2024
"Për miratimin e delegimit të kompetencës për përfaqësimin ligjor të Bankës së Shqipërisë në Programin për Harmonizimin e Vrojtimeve të Besimit Konsumator dhe të Biznesit të Komisionit Evropian" 10
 5. Vendim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, nr.prot. 5287, datë 30.12.2024
"Për caktimin e shtesës kundërciklike të kapitalit" 11
-
- Vendimet e miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, gjatë vitit 2024 13



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM
Nr. 62, datë 4.12.2024

PËR
RISHTYPJEN E MONEDHAVE METALIKE SHQIPTARE ME KURS
LIGJOR, ME PRERJE 5 LEKË DHE 10 LEKË

Në bazë dhe për zbatim të nenit 33, pikat 2 dhe 3, nenit 36, nenit 39 pika 2, dhe nenit 43, shkronjat "c" dhe "d", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 16 të rregullores "Për shtypjen, rishtypjen, hedhjen dhe tërheqjen nga qarkullimi të kartëmonedhave dhe monedhave metalike shqiptare me kurs ligjor", miratuar me vendimin nr. 133, datë 7.12.2016, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, me propozim të Departamentit të Emisionit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rishtypjen e monedhave metalike shqiptare me kurs ligjor me prerje 5 Lekë dhe 10 Lekë, në përputhje me përcaktimet e anekseve 1 dhe 2 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Viti i shtypjes, i shfaqur në trupin e monedhave metalike, të jetë viti 2024.
3. Ngarkohet Departamenti i Emisionit me zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë, me përjashtim të aneksit që përmban informacion të klasifikuar jopublik "sekret bankar".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM
Nr. 64, datë 4.12.2024

**PËR
CAKTIMIN E KONTROLLORIT TË JASHTËM TË PASQYRAVE
FINANCIARE TË BANKËS SË SHQIPËRISË DHE TË FONDIT TË
PENSIONIT SUPLEMENTAR PËR VITET 2024-2028**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronjat "c" dhe "g", dhe nenit 68 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 36, datë 25.6.2014, "Për miratimin e procedurës së veçantë të prokurimit për përzgjedhjen e audituesit të jashtëm të pasqyrave financiare të Bankës së Shqipërisë dhe të Fondit të Pensionit Suplementar", i ndryshuar; si dhe mbështetur në raportin e vlerësimit të Komisionit të Prokurimit, ngritur me urdhrin nr. 4174, datë 12.6.2024, të paraqitur nga Kryetari i Entit Prokurues, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të caktojë Degën në Shqipëri të shoqërisë ERNST & YOUNG Ekspertë Kontabël të autorizuar, si kontrollor të jashtëm të pasqyrave financiare të Bankës së Shqipërisë dhe të Fondit të Pensionit Suplementar, për vitet 2024-2028, sipas ofertës të paraqitur pranë Bankës së Shqipërisë në datë 14.11.2024, për procedurën e veçantë të prokurimit me objekt "Përzgjedhja e audituesit të jashtëm të pasqyrave financiare të Bankës së Shqipërisë dhe të Fondit të Pensionit Suplementar, për vitet 2024-2028".
2. Ngarkohet Kryetari i Entit Prokurues me shpalljen e ofertës fituese dhe lidhjen e kontratës pas përfundimit të afatit të parashikuar për ankimin administrativ.
3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM
Nr. 65, datë 18.12.2024

PËR
MBAJTJEN E PANDRYSHUAR TË NORMËS SË INTERESIT TË
MARRËVESHJEVE TË RIBLERJES DHE TË ANASJELLA TË RIBLERJES
DHE TË NORMAVE TË INTERESIT TË DEPOZITËS NJËDITORE DHE TË
KREDISË NJËDITORE NË BANKËN E SHQIPËRISË

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronjat "a" dhe "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 2.75 për qind, normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes (REPO dhe REPO të anasjella).
2. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 1.75 për qind, normën e interesit që Banka e Shqipërisë i paguan një banke tregtare për depozitën njëditore.
3. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 3.75 për qind, normën e interesit që një bankë tregtare i paguan Bankës së Shqipërisë për kredinë njëditore.
4. Ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare të njoftojë menjëherë bankat tregtare për këtë vendim.
5. Ngarkohen Departamenti i Operacioneve Monetare dhe të gjitha strukturat e tjera në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në faqen zyrtare të internetit dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM
Nr. 68, datë 18.12.2024

**PËR
MIRATIMIN E DELEGIMIT TË KOMPETENCËS
PËR PËRFAQËSIMIN LIGJOR TË BANKËS SË SHQIPËRISË NË
PROGRAMIN PËR HARMONIZIMIN E VROJTIMEVE TË BESIMIT
KONSUMATOR DHE TË BIZNESIT TË KOMISIONIT EVROPIAN**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 53, pika 4, paragrafi i fundit i ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; neneve 28 dhe 29 të ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; dhe bazuar në propozimin e Guvernatorit dhe të Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të autorizojë Zëvendësguvernatorin e Parë për përfaqësimin ligjor të Bankës së Shqipërisë në Programin për Harmonizimin e Vrojttimeve të Besimit Konsumator dhe të Biznesit të Komisionit Evropian, si dhe për nënshkrimin e të gjithë dokumentacionit në funksion të përmbushjes së qëllimit të këtij programi, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
2. Ngarkohet Zëvendësguvernatori i Parë dhe Departamenti i Politikës Monetare me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas publikimit në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

SEKRETARI

KRYETARI

ELVIS ÇIBUKU

GENT SEJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
GUVERNATORI

Nr. 5287

Tiranë, më 30.12.2024

VENDIM
Nr. 5287, datë 30.12.2024

PËR
CAKTIMIN E SHITESËS KUNDËRCIKLIKE TË KAPITALIT

Në bazë dhe për zbatim të neneve 11, 12 dhe nenit 16, pika 1, shkronja "ç", të rregullores "Për shtesat makroprudenciale të kapitalit" miratuar me vendimin nr. 41, datë 5.6.2019 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, bazuar në propozimin e Departamentit të Stabilitetit Financiar,

VENDOSA:

1. Norma e shtesës kundërciklike të kapitalit (KUNC) për Shqipërinë rritet në 0.50 (zero pikë pesëdhjetë) për qind.
2. Bankat duhet të raportojnë shkallën e përmbushjes së shtesës kundërciklike të kapitalit sipas paragrafit 1, duke filluar me datën 31 dhjetor 2025.
3. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare dhe në Buletin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
4. Ngarkohen Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

GUVERNATOR

GENT SEJKO

**VENDIMET E MIRATUARA NGA KËSHILLI MBIKËQYRËS I BANKËS SË SHQIPËRISË,
GJATË VITIT 2024**

Vendimi		Vendime dhe Rregullore	Buletini Zyrtar	
Nr.	Datë		Vëllimi	Nr.
Licencë nr. 55	3.11.2023	Për të vepruar si institucion i parasë elektronike në Republikën e Shqipërisë	26	1
2	24.1.2024	Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit për Sistemet e Pagesave	26	1
3	24.1.2024	Për miratimin e disa ndryshimeve në kontratën tip për riblerjen e titujve	26	1
5	24.1.2024	Për miratimin e Strategjisë të Bankës së Shqipërisë "Për krijimin e monedhave pa kurs ligjor, përkujtimore dhe për qëllime numizmatike për 2024-2029"	26	1
6	24.1.2024	"Për miratimin e Strategjisë të Bankës së Shqipërisë për edukimin dhe përfshirjen financiare, 2024-2026"	26	1
7	24.1.2024	Për miratimin e delegimit të kompetencës për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bankës së Shqipërisë dhe Akademisë së Sigurisë	26	1
nr.prot 644	6.2.2024	Për pezullimin e licencës së subjektit financiar jobankë "Micro Credit Albania"	26	2
9	7.2.2024	Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë	26	2
10	7.2.2024	Për miratimin e udhëzimit "Për raportimin e incidenteve madhore"	26	2
11	7.2.2024	Për disa ndryshime në rregulloren "Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare"	26	2
12	7.2.2024	Për miratimin e rregullore "Për procedurat e krijimit dhe shtypjes së monedhave dhe kartëmonedhave pa kurs ligjor, përkujtimore për qëllime numizmatike, dhe medaljoneve përkujtimore nga Banka e Shqipërisë"	26	2

15	6.3.2024	Për një ndryshim në rregulloren "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit"	26	3
16	6.3.2024	Për shtypjen e monedhës metalike përkujtimore, për qëllime numizmatike, me tematikë "100 vjet Banka e Shqipërisë, 1925-2025"	26	3
17	20.3.2024	Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë	26	3
18	20.3.2024	Për miratimin e pasqyrave financiare të Bankës së Shqipërisë për vitin 2023	26	3
nr.prot 1481	2.4.2024	Për caktimin e shtesave makroprudenciale të kapitalit	26	3
21	3.4.2024	Për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e kërkesave për transfertat e kreditit dhe të debitimit direkt në Euro"	26	3
24	3.4.2024	Për rishtypjen e kartëmonedhës shqiptare me kurs ligjor, me prerje 200 Lekë dhe 500 Lekë	26	3
26	8.5.2024	Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë	26	4
27	8.5.2024	Për "Një ndryshim në vendimin nr. 36, datë 25.6.2014 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për miratimin e procedurës së veçantë të prokurimit për përzgjedhjen e audituesit të jashtëm të pasqyrave financiare të Bankës së Shqipërisë dhe të fondit të pensionit suplementar", i ndryshuar	26	4
28	8.5.2024	Për miratimin e "Dokumentit të politikës së investimit të fondit të pensionit në Bankën e Shqipërisë"	26	4
29	8.5.2024	Për disa ndryshime në rregulloren "Për krahasueshmërinë e tarifave të lidhura me llogaritë e pagesave dhe për shërbimin e transferimit të llogarive të pagesave"	26	4
30	8.5.2024	Për disa ndryshime në rregulloren "Për sigurinë e informacionit"	26	4

31	8.5.2024	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 17, datë 23.3.2023 "Për miratimin e konfigurimeve të vizatimeve të monedhës përkujtimore, që do të shtypet për qëllime numizmatike në vitin 2023"	26	4
nr.prot 2302	23.5.2024	Për revokimin e licencës së subjektit financiar jobankë "Micro Credit Albania" SH.P.K.	26	4
nr.prot 2303	23.5.2024	Për revokimin e licencës së subjektit financiar jobankë "Final" SH.P.K.	26	4
nr.prot 2454	4.6.2024	Për hedhjen në qarkullim të monedhave metalike shqiptare, me kurs ligjor, me vlerë nominale 5 Lekë	26	4
32	5.6.2024	Për miratimin e lirit nga detyra të drejtorit të Departamentit për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme të Bankës së Shqipërisë	26	4
33	5.6.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka"	26	4
nr.prot 5427	28.12.2023	Për miratimin e politikës së administrimit të mjeteve financiare të fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme	26	5
nr.prot 2819	27.06.2024	Vendim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë	26	5
nr.prot 2820	27.06.2024	Vendim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë	26	5
34	3.07.2024	Për uljen e normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë	26	5
35	3.07.2024	Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren "Për politikën dhe mënyrën e administrimit të arit"	26	5
36	3.07.2024	Për miratimin e një ndryshimi në rregulloren "Për funksionimin e sistemit qendror të regjistrimit dhe shlyerjes së titujve (AFISaR)"	26	5

39	3.07.2024	Për miratimin e delegimit të kompetencës për nënshkrimin e marrëveshjes së konfidencialitetit midis bankave qendrore në kuadër të pjesëmarrjes në projektin DCTF-ii (The Data Collection Task Force-ii) të rrjetit "Historia monetare e Evropës Juglindore (South-Eastern European Monetary History Network - SEEMHNI)"	26	5
nr.prot 2680	20.6.2024	Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në rregulloren nr. 3762, datë 18.7.2016 "Për kompensimin e depozitave të siguruara"	26	6
nr.prot 2852	28.6.2024	Për caktimin e shtesës kundërciklike të kapitalit	26	6
nr.prot 5024	17.7.2024	Për pezullimin e ushtrimit të veprimtarive financiare dhe marrjen e masave mbikëqyrëse për Shoqërinë e Kursim-Kreditit "Rushkull One"	26	6
nr.prot 5416	2.8.2024	Për pezullimin e ushtrimit të veprimtarive financiare të shoqërisë së kursim-kreditit "Perlat" dhe përfundimin e procesit të bashkimit me përthithje me shoqërinë e kursim-kreditit "Rushkull One"	26	6
40	7.8.2024	Për miratimin e raportit tremujor të politikës monetare	26	6
41	7.8.2024	Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë	26	6
42	7.8.2024	Për disa ndryshime në rregulloren "Për licencimin, ushtrimin e veprimtarisë, revokimin e licencës dhe likuidimin e portofolit të kredive të krijuar nga ushtrimi i veprimtarisë financiare nga subjektet financiare jobanka"	26	6
43	7.8.2024	Për miratimin e rregullore "Për informacionin që shoqëron transfertat e fondeve"	26	6
nr.prot 4036	1.10.2024	Për caktimin e shtesës kundërciklike të kapitalit	26	7
46	2.10.2024	Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë	26	7

47	2.10.2024	Për disa ndryshime në rregulloren "Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka"	26	7
48	2.10.2024	Për miratimin e rregullores "Për kërkesat minimale të sigurisë në ambientet ku kryhen veprimtaritë bankare e financiare, dhe për transportin e vlerave monetare"	26	7
50	6.11.2024	Për uljen e normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë	26	7
51	6.11.2024	Për miratimin e rregullores "Për administrimin e rrezikut operacional nga bankat, institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike"	26	7
52	6.11.2024	Për disa ndryshime në rregulloren "Për administrimin e rrezikut operacional"	26	8
53	6.11.2024	Për disa ndryshime në rregulloren "Mbi raportimet në Bankën e Shqipërisë sipas sistemit raportues të unifikuar"	26	8
54	6.11.2024	Për miratimin e rregullores "Mbi kriteret dhe metodikën për caktimin e çmimeve të shitjes së artikujve numizmatikë për shitje"	26	8
56	6.11.2024	Për miratimin e delegimit të kompetencës për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bankës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve (EIB)	26	8
57	6.11.2024	Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 81, datë 15.11.2006 "Për miratimin e rregullores "Për procedurat e prokurimit në Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar"	26	8
58	20.11.2024	Për miratimin e "Strategjisë afatmesme të zhvillimit të Bankës së Shqipërisë për periudhën 2025-2027"	26	8
61	20.11.2024	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 4, datë 24.1.2024 "Për rishtypjen e monedhave metalike shqiptare me kurs ligjor, me prerje 50 Lekë dhe 20 Lekë"	26	8
nr.prot 4790	20.11.2024	Për dhënien e miratimit paraprak për ushtrimin e veprimtarive shtesë të shërbimit të inicimit të pagesës dhe të shërbimit të informimit të llogarisë nga institucioni i parasë elektronike "Easypay" sh.p.k.	26	8

62	4.12.2024	Për rishtypjen e monedhave metalike shqiptare me kurs ligjor, me prerje 5 Lekë dhe 10 Lekë	26	9
64	4.12.2024	Për caktimin e kontrollorit të jashtëm të pasqyrave financiare të Bankës së Shqipërisë dhe të fondit të pensionit suplementar për vitet 2024-2028	26	9
65	18.12.2024	Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë	26	9
68	18.12.2024	Për miratimin e delegimit të kompetencës për përfaqësimin ligjor të Bankës së Shqipërisë në Programin për Harmonizimin e Vrojtimeve të Besimit Konsumator dhe të Biznesit të Komisionit Evropian	26	9
nr.prot 5287	30.12.2024	Për caktimin e shtesës kundërciklike të kapitalit	26	9

